

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_\_

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20.000 zgjedhësve,

KUVENDI I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 3, pas pikës 4 shtohet pika 4.1 me përmbajtje:

4.1 Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një votë parapëlqyese për kandidatët e listës shumëemrore të vetëm një subjekti zgjedhor.

Neni 2

Në nenin 67, pas pikes 4 shtohet pika 4.1, me permbajtje:

4.1 Emrat në listën shumëemrore të subjektit zgjedhor per kandidatet per këshillin e njësisë vendore, paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumëemrore duhet të jetë i barabartë me numrin e antareve të këshillit te njesise vendore, shtuar 1 në rast se nuk plotëpjestohet me dy.

Neni 3

Në nenin 67, pas pikes 6 shtohet pika 6.1, me përmbajtje:

6.1 Ne listen shumëemrore per keshillin e njesise vendore subjekti zgjedhor duhet te perfshije kandidatë nga komunitetet rurale, urbane dhe pakicat kombetare, ne

perputhje me parimin e propocionalitetit në përfaqësim, duke ju referuar numrit të banoreve që ju perkasin ketyre komuniteteve. Jo me vone se 30 dite nga shpallja e dekretit per daten e zgjedhjeve per organet e pushtetit vendor , zyra e gjendes civile ne njësinë vendore, publikon perqindjet që zënë komunitetet e ndryshme në strukturën e pergjithshme te popullates që banon ne njësinë vendore perkatese

#### Neni 4

Në nenin 98, pas pikes 3 shtohet pika 3.1 me perte neisise vendore vendosen ne fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti i hedhur per subjektet politike. Perbri tyre shkruhet emri i subjektit, sigla dhe shkronja nistore. Çdo kandidati që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi. Në rast se ne njësinë vendore është i rregjistruar vetëm një kandidat, në hapsirën përkatëse për shënimin e votës, vendosen dy alternativa: Pro [] Kundra [].

#### Neni 5

Në nenin 98, pika 4, fjalia e parë, pas shprehjes “Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin” shtohet togfjaleshi:  
“dhe për këshillin e njësisë vendore”

#### Neni 6

Në nenin 106, pas pikes 1, shtohet pika 1.1, me përmbajtje:

1.1 Per zgjedhjet per organet të pushtetit vendor zgjedhesi voton ne dy fletë votimi. Pasi merr dy fletët e votimit zgjedhesi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe, ne fletën e votimit per kryetar te njësisë vendore shenon ne vendin perkates të fletës se votimit per kandidatin që desheron shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Ne rast se votohet vetëm per nje kandidat zgjedhesi vendos “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e tij per alternativën perkatese, Po, ose Jo. Në fletën e votimit per këshillin e njësisë vendore zgjedhesi shënon në vendin, e përcaktuar nga fleta e votimit, për subjektin zgjedhor shenjen “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Pas

kesaj, vendos “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij, për një nga kandidatët e listës shumëemrore të subjektit që ka zgjedhur më parë.

#### Neni 7

Në nenin 117, pas pikes 2, shtohet pika 2.1, me përmbajtje:

2.1 Per zgjedhjet per organet e pushtetit vendor vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht, sipas rastit, vetëm për njërin nga kandidatët per kryetar te njësisë vendore, për njërën nga alternativat Pro ose Kunder, per njërin nga subjektet zgjedhore dhe vetëm për njërin nga kandidatët e tij për antar në këshillin e njësisë vendore. Kur është votuar për më shumë se një kandidat per antar të këshillit të njësisë vendore, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor. Kur është votuar vetem për kandidat për këshillin e njësisë vendore vota është e pavlefshme

#### Neni 8

Në nenin 120, pas piks 10, shtohet pika 10.1, me përmbajtje:

10.1 Pas përfundimit të procedurave të parashikuara ne dipozitat e mësipërme të ketij neni, bëhet numërimi, sipas së njëjtës procedurë, i votave parapëlqyese për çdo kandidat per antar të këshillit te njësisë vendore, të çdo subjektit zgjedhor.

#### Neni 9

Neni 166, ndryshon:

Pika 1, në fund të fjalisë shtohet:

Kur është votuar per nje kandidat të vetëm, kandidati zgjidhet kryetar ne rast se numri i votave ku është votuar alternativa Pro është me i madh se numri i votave ku është votuar alternativa Kundër. Ne rast të kundert KQZ vendos perseriten, pas jo me shpejtë se 4 jave, të zgjedhjeve per kryetar ne njësinë vendore përkatëse.

Pika 3 fjalia:

*“Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në listën e kandidatëve me rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një” zëvendësohet me fjalinë:*

*“Lista e kandidatëve për antar në këshillin e njësisë vendore e çdo subjekti zgjedhor rirenditet, sipas numrit të votave parapëlqyese të fituara nga kandidatët, në rendin*

zbritës. Pas rirenditjes se kandidatëve që kane fituar vota parapëlqyese, lista vazhdon me renditjen e emrave të kandidatëve që nuk kanë fituar asnjë votë parapëlqyese duke ruajtur renditje e mepareshme, në raport me njeri tjetrin. Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në listën e rirenditur të kandidatëve me rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një” .

Neni 10

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 15 ditë pas botimit ne fletoren zyrtare

K R Y T A R E

**Lindita NIKOLLA**

## **Relacion**

Për projektligj për

Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

### **I. Qellimi i projektligjit dhe objektivat që synohen të arrihen**

Qellimi i këtij projektligji është përmirësimi i demokracisë përfaqësuese në pushtetin vendor me objektiv rritjen e cilësive në administrimin e punëve vendore dhe shërbimeve për komunitetin.

Projekt ligji synon:

- a. Rregullimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së zgjedhësve për të zgjedhur, në mënyrë direkte, përfaqësuesit e tyre në keshillin e njësisë vendore
- b. Krijimin e hapsirës ligjore për përfaqësimin proporcional, në keshillin e njësisë vendore, të komuniteteve që bashkejetojnë në një njësi vendore

### **II. Argumentimi i projekt aktit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme**

Zgjedhja e antarëve të keshillave të njësisë vendore sipas kërkesave të sistemit proporcional me lista të mbyllura, bënë që në fletën e votimit zgjedhësi të ketë mundësinë të zgjedhë vetëm subjektin, partinë politike, koalicionin ose kandidatit të pavarur. Për pasoje, ushtrimi i të drejtës kushtetuese për të zgjedhur, është i kufizuar dhe realizohet si një proces indirekt, duke e kushtëzuar zgjedhësin që me votën e tij të mbështetë njëherazi edhe kandidatit të preferuar prej tij por edhe kandidatit të tjerë, të cilët nënkohë do të preferonte t'i mbështetë.

Kjo pamundësi e zgjedhësit për të përcaktuar se cilët prej kandidatëve kanë më shumë përparësi për të marrë mandatin e antarit të keshillit të njësisë vendore, ndikon negativisht në funksionimin efektiv të lidhjeve midis zgjedhësve dhe të zgjedhurëve. Kjo mënyrë zgjedhje dobeson lidhjet midis tyre.

Për më tepër, duke ju referuar mënyrës se si është zbatuar deri sot ky sistem për zgjedhjen e keshillave të njësisë vendore, sipas të cilit subjektet garuese kanë detyrimin që, në listat e kandidatëve të respektojnë vetëm kërkesën për barazim gjinorë, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, fakti se, zbatimi i reformës territoriale-administrative krijoi njësi vendore me shtrirje të mëdha në territor, të cilin banojnë komunitetet me karakteristika ekonomike, sociale, kulturore dhe të sjelljes me diferencë të ndjeshme, kanë bërë që zgjedhja e keshilltarëve sipas ligjislacionit aktual, të ketë si produkt të saj formimin e keshillave në të cilët përfaqësimi i këtyre komuniteteve të mos jetë proporcional.

Mënyra aktuale që zbatohet për zgjedhjen e keshillave, nuk gjeneron efekte shtytëse, tek një pjesë e konsiderueshme e zgjedhësve, për të marrë pjesë në zgjedhje.

Ndryshimet që propozohen, në këtë projekt ligj, të cilat:

nga njera ane i krijojnë mundësi zgjedhëse për të zgjedhur kandidatin që desherojnë për antar në keshillin e njësisë vendore nepermjete votimit me votë parapëlqyese dhe

nga ana tjetër detyrimi për subjektet zgjedhore për të hartuar listat e kandidatëve duke respektuar parimin e proporcionalitetit në përfaqësim, krijojnë mundësi ligjore që zgjedhja e keshillit të njësisë vendore të realizohet në përputhje me kërkesat për ndërtimin e institucioneve efektive me të cilët vepron demokracia përfaqësuese në nivelin vendor.

Në projekt ligj është trajtuar edhe rasti kur për kryetar të njësisë vendore kandidon një kandidatë i vetëm. Për këtë rast projekt ligji parashikon votimin për një nga alternativat *Pro* ose *Kunder*. Në rastin kur votat *Kunder* janë më shumë se ato *Pro*, KQZ vendos për ripërsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në njësinë vendore përkatëse. Në këtë mënyrë synohet që të zvogëlohet efekti negativ që mund të sjell votimi për një kandidat të vetëm, në cilësinë e përfaqësimit prej tij, të komuniteteve që do të qeveris si kryetar i njësisë vendore

### **III. Vlerësimi i ligjshmerisë, kushtetutshmerisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi**

Projektligji është paraqitur si nismë ligjvënese qytetare, mbështetur në dispozitën kushtetuese, neni 81, pika 1. Realizimi i kësaj nisme është bërë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligin nr. 54/2019 "Për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë"

Nepermjet amendimit të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, projekt ligji do të i shërbejë rregullimit me të mirë dhe me efektiv të kuadrit ligjor në zbatim të të cilit shtetasit shqiptar ushtrojnë të drejtën kushtetuese për të zgjedhur organet përfaqësuese për vetëqeverisjen vendore. Në këtë mënyrë kuadri ligjor për zgjedhjen e këtyre organeve arrin të përfrohet me mirë me kërkesat e dokumentave dhe konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë.

Projekt ligji është mbështetur nga 20.000 zgjedhës.

### **IV. Vlerësimi për efektin financiar**

Projektligji nuk përçjell efekte financiare shtesë në Buxhetin e shtetit.